

STATUTI
I SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
“**Finance and Legal**”

Sot me date 24/08/2022 Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar “**Finance and Legal**”, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”, zotërohet nga ortaku:
Arsen Memaj i datëlindjes 06/07/1990 shtetas shqiptar, lindur në Shkoder dhe banues në Tirane, i cili identifikohet me karte identiteti me numër personal J00706119H

Te cilet në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë miratojnë statutin e shoqërisë “**Finance and Legal**”, në bazë të parimeve të mëposhtme:

KAPITULLI I
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI

NENI 1
FORMA DHE EMRI

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

1.2 Emri i shoqërisë është “**Finance and Legal**”, forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

NENI 2
BAZA LIGJORE



Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3
SELIA

Selia e shoqërisë është në adresën: **Tirane, Rruga Komuna e Parisit me zone kadastrale nr. 8260 me nr. Pasurie 6/251-N6**

Me adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik. Me vendim të asamblesë së ortakëve mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

NENI 4
TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra, filiale ose përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të krijohen dhe do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II
OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

5. Shoqëria “Finance and Legal”, është e organizuar në formën e një shoqërie të prodhimit dhe tregtimit në të gjithë komponentët e saj dhe ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

Shoqëria ka për objekt kryesor shërbime të konsulences financiare, konsulences fiskale, për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit fiskal, administrative, mbajtje kontabiliteti për të gjitha llojet e shoqërive dhe të personave fizike dhe shërbime të tjera konsulente të biznesit në përgjithësi. Përgatitjen e planeve të biznesit për nevojat e drejtuesve dhe për palet e treta, keshillime biznesi mbi mundësitë e zhvillimit, keshillime për aktivitetin tregtar etj. Ngritja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kontabel dhe të kontrollit të brendshëm të njësive



ekonomike si dhe trajnimin profesional te personelit qe eshte ringarkuar me funksionimin e ketyre sistemeve etj. ekspertize kontabel, shërbim konsulence marketingu dhe tregu, asistencë në ngritjen dhe themelimin e shoqërive (sipërmarrjeve) publike dhe private. Shërbime auditimi financiar ,perfaqesim tatimor, konsulence financiare, bilance, listepagesash.Sherbime ndaj paleve te treta ,Trajnime Kontabiliteti me programe finaciare te Informatizuar etj. Mbajtje e llogarive kontabel dhe regjistrim i transaksioneve tregtare per bizneset. Asistence operacionale lidhur me hartimin e metodave te llogaritjes se kosos, politikave te burimeve njerezore,marrjen e vendimeve te natyres financiare dhe marketingut. Sherbime ndaj paleve te treta , Sherbime ndermjetesimi , sherbime tregtare të përshkruara në vijim: shitblerjen,dhënien me qira, menaxhimin, ristrukturimin, administrimin e pasurive të paluajtshme, pasurive të luajtshme te regjistruara dhe të pasurive te luajtshme; lidhjen e kontratave të leasing me objekt pasuri te paluajtshme dhe/ose të pasurive ndihmëse, në cilësinë e qiramarrësit; analizë tregu, biznes plan, planifikim tregtar, menaxherial dhe financiar. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tregtar, industrial, \financiar, me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, me efekte detyruese ndërmjet palëve apo edhe kundrejt të tretëve, në përputhje me ligjet në fuqi Lidhur me aktivitetin e përmendur me sipër, ne përputhje me legjislacionin ne fuqi, mbetet e kuptuar se detyra te tilla profesionale do t'i ngarkohen drejtëpërdrejt profesionistëve, rregullisht te aktivizuar ne varësi te rastit, nën përgjegjësinë e tyre.

5.4 Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtëpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakëve.

NENI 6 KOHËZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të asamblese së ortakëve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

KAPITULLI III

LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI,DOKUMENTET E DISTINUARA PER TË TRETËT

NENI 7



LIBRI I SHOQËRISË

Për të saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marredhëniet e punës, shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet libri i shoqërisë.

NENI 8 KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërise si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 9 DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “Sh.P.K.”, si dhe emrin e administratorit ose te administratorëve.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRASFERIMI I TYRE

NENI 10 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është : 100,000 Lek (Njeqindmije lek), zoterues i nje kuote me 100% te aksioneve ortaku Arsen Memaj

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dytë.

NENI 11 TË DREJTAT E ORTAKËVE NË LIDHJE ME KAPITALIN

11.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.



11.2 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

11.3 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra permbarimore ose ndonje organ tjetër kompetent), duhet të ketë në konsideratë respektimin e kërkesave të nenit 14 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin të shpjegojë nenin 14 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguroese.

11.4 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital.

11.5 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërisë kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërisë, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabël e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

NENI 12 FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 13 FINANCIMI I SHOQËRISË

13.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.

13.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nepërmjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 14 LENIA DHE TRASFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

14.1 Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen lirisht mes ortakëve të shoqërisë. Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërisë në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës sëparablerjes.

14.2 Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i pjesëve të tij tek persona të tretë bëhet vetëm në këtë mënyrë:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim;



- Oferta duhet të përcaktoje numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;
Nëse ortakët e shoqërisë brënda tre muajsh nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e kërkuar, atëherë ata konsiderohet se lejojnë shitblerjen tek të tretët.

14.3 Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rrugë trashigimie. Bashkshorti, paraardhësit mund të bëhen ortakë nepërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

14.4 Trasferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohen me akt noterial dhe të depozitohen në organin kompetent.

KAPITULLI V **ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

NENI 15 ORGANET DREJTUESE

15.1 Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë asambleja e ortakëve dhe administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësojë shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

15.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorin e shoqërisë “**Finance and Legal**” ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

15.3 Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.

15.4 Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare është Arsen Memaj i datëlindjes 06/07/1990 shtetas shqiptar, lindur në Shkoder dhe banues në Tirane, i cili identifikohet me karte identiteti me numër personal J00706119H

KAPITULLI VI **ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

NENI 16 VENDIMET E ASAMBLESEË TE ORTAKËVE

16.1 Asambleja e ortakëve vendos për çështjet që ligji apo ky statut ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

16.2 Vendimet e zakonshme të asamblesë së ortakëve merren me votën e ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e kuotave të kapitalit themeltar, përveç rasteve



kur ligji apo statuti kërkon një shumicë të ndryshme.

16.3 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 17 KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKËVE

17.1 Në përputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakëve mund të merren pas një konsultimi me shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këtë rast, organi administrativ i komunikon ortakëve tekstin e projekt-vendimit që do të merret dhe i kërkon të shprehin vullnetin e tyre në lidhje me këte çështje.

17.2 Vendimet e marra në këte menyrë janë të vlefshme kur vendimi merret nga shumica që ligji apo ky statut kërkon për atë çështje.

NENI 18 MËNYRA DHE VENDI I THIRRJES SË ASAMBLESË SË ORTAKËVE

18.1 Asambeja e ortakëve thirret pranë selisë së shoqërisë, apo në ndonjë vend tjetër brenda apo jashtë Shqipërisë, nepërmjet një njoftimi me shkrim që iu dërgohet ortakëve nga kryetari i asamblesë së ortakëve dhe/ose organi administrativ në e-mail:

- **“arsen.n.memaj@gmail.com”** dhe në numër telefoni **0697295953**

18.2 Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë duhet të kryhet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes dhe duhet të përcaktojë shprehimisht datën, orën, vendin si dhe rendin e ditës. Në rast pamundësie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblesë së ortakëve mund të thirret nga eksperti kontabël i autorizuar, nëse ka të tillë, ose nga një apo më shumë ortakë, të cilët përfaqësojnë jo më pak se 10% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 19 KRYETARI I MBLEDHJES SE ASAMBLESË SË ORTAKËVE

19.1 Mbledhja e asamblesë së ortakëve emëron kryetarin e asamblesë.

19.2 Kryetari i asamblesë verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt të asamblesë së ortakëve, vërteton identitetin apo legjitimitimin e përfaqësuesit të ortakëve dhe drejton zhvillimin e rregullt të mbledhjes.

NENI 20



PJESËMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak ka të drejten e një vote për cdo kuotë të kapitalit themeltar të shoqërisë që ai zotëron. Një ortak mund të përfaqësohet në mbledhjen e asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, nepërmjet një akti përfaqësimi me shkrim.


NENI 21 KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË ORTAKËVE

21.1 Asambleja e ortakëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme, kjo në varësi të çështjes për të cilën është thirrur. Vendimet e asamblesë së zakonshme të ortakëve merren vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve merren me një shumice të cilësuar prej 3/4 të votave të ortakëve të shoqërisë. Për çfarë nuk është pasqyruar në këtë nen, asambleja e ortakëve të shoqërisë vendos në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04. 2008, i ndryshuar.

21.2 Kompetencat e asamblesë së zakonshme të ortakëve do të jenë:

- Vendos për përpilimin ose miratimin e rregulloreve për shoqërine apo për fusha e vecanta të veprimtarisë.
- Vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë.
- Vendos për krijimin e zyrave ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive ose të ortakërive me persona të tjere fizike apo juridike.
- Vendos për politiken afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
- Emëron dhe shkarkon me një shumice të cilësuar prej 3/4 të votave të ortakëve të shoqërisë : administratorin e shoqërisë, ekspertin kontabël, likuidatorin duke përcaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, të drejtat, detyrimet, kohëzgjatjen në detyrë, dhe shpërblimin e tyre.
- Vendos në lidhje me krijimin e organeve të tjera drejtuese që mund ti nevojiten shoqërisë duke përcaktuar në aktet e krijimit të këtyre organeve, kohëzgjatjen dhe kompetencat e tyre, për emerimin e personave drejtues të këtyre organeve.
- Asambleja e ortakëve marrjen e vendimeve e kryen vetë dhe nuk bën delegimin e vendimarrjes te asnjë organ tjetër. Asambleja e ortakëve vendos edhe në lidhje me krijimin e sektorëve të veçante të veprimtarisë së shoqërisë.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor, përcakton llojin e fondeve të ndryshme dhe masen e tyre, përcaktimin e dividendit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marrëdhëniet më të rëndësishme ekonomike dhe financiare të shoqërisë me persona të tjere fizik apo juridik, vendas apo të huaj.
- Miraton një tabelë për tarifën e shërbimeve të shoqërisë sipas fushave
- Vendos në lidhje me transferimin e pjeseve të kapitalit themeltar të shoqërisë.

21.3 Kompetencat e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve janë:



- Vendos në lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - Vendos në lidhje me kohëzgjatjen e shoqërise si dhe për mbarimin e likuidimin e saj.
 - Vendos për ndryshimin e emrit të shoqërisë.
 - Vendos në lidhje me ndryshimin e statutit të shoqërisë.
 - Vendos për ndryshimin e formës, për ndarjen e shoqërisë si dhe përbashkimin e saj me shoqëri të tjera.
- 21.4 Përveç kompetencave të lartpërmendura, të cilat janë ekskluzive për të, asambleja e ortakëve ushtron çdo kompetence që ia njeh ligji.
- 21.5 Asambleja e ortakëve në rastet kur nuk ka emëruar administrator, kryen dhe kompetencat që në këtë statut janë përcaktuar për këtë të fundit. Gjithashtu, asambleja e ortakëve mund të kufizojë administratorin në ushtrimin e kompetencave të tij.

NENI 22 ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

22.1 Kompetencat e administratorit ose të administratoreve, në mënyre konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e tyre të emerimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

- Kujdeset për funksionimin e përditshem normal të shoqërise ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emerimit.
- Përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ia paraqet asamblesë së ortakëve për shqyrtim.
- Kordinon veprimtarinë e personave të punësuar në shoqëri.
- Ndjek problemet e shoqërise në marrëdhënie me organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.
- I propozon asamblesë së ortakëve tarifat e shërbimeve dhe pagat për personelin e punësuar në shoqëri.
- I propozon asmblesë së ortakëve rregulloren e shoqërisë.
- Administratoret kanë të drejtë të gjithë sëbashku ose veçmas nga njeri tjetri të përfaqësojnë shoqërinë në lidhje me të tretët.

22.2 Administratori ose administratorët janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë ushtrimit të administrimit të shoqërisë. Përgjegjësia është individuale ose solidare, kjo në varësi të rrethanave dhe të mënyrës sesi është vepruar, pra individualisht ose solidarisht.



KAPITULLI VII

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET, KONTROLLI KONTABËL

NENI 23 KONTROLLI KONTABËL

Kontrolli i jashtëm kontabël i shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi. Asambleja e ortakëve do të emerojë një apo më shumë eksperte kontabël në ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 24 LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqëria është e detyruar të mbaje, përveç librit të shoqërisë, në të cilin shënohen emrat e plotë të ortakëve dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e asamblesë së ortakëve, edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

NENI 25 BILANCI DHE REZERVAT

25.1 Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar, i paraqiten për shqyrtim asamblese së ortakëve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e këtyre akteve, kur e konsideron të nevojshme asambleja e ortakëve mund të bëjë rekomandimet e nevojshme në lidhje me çështjenë diskutim.

25.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, administratori i vetëm merr masat e nevojshme për hartimin e projekt-bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që asambleja e ortakëve të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

25.3 Asambleja e ortakëve vendos mbi ndarjen ndërmjet ortakëve të shumave që rezultojnë si fitime sipas bilancit të aprovuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme, si dhe të jenë lënë mënjanë shumat e nevojshme për krijimin e rezervës ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nëpërmjet lënies mënjanë të një shume të barabartë me 5 % të fitimit neto të realizuar gjatë secilit vit financiar, deri sa të arrihet një shume e barabartë me 10 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

25.4 Asambleja e ortakëve në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave të tjera, si dhe masën e tyre.



KAPITULLI VIII
MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 26
MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakeve ose kur ka nje prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

NENI 27
LIKUJDIMI

27.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja e ortakeve cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

27.2 Në fund të procesit të likujdimit, asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

27.3 Mbas pagimit të kreditorëve asambleja e ortakëve mban pjesën e mbetur të kapitalit që u shperndahet ortakëve.

KAPITULLI IX
MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 28
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarreveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do të angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet gjykata kompetente për gjykimin e mosmarreveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane

NENI 29
DISPOZITA TE FUNDIT



29.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjislacioni shqiptar në përgjithësi.

29.2 Ky statut është hartuar ne 2 (Dy) ekzemplare, në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplare fuqi tënjëjtë ligjore.

“Finance and Legal ”

Ortaku

Arsen Memaj

Arsen Memaj¹
